RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 1363/18
Data 26.10.2018
PRISHTINË

METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË NDËRLIKUESHMËRISË SË VENDEVE TË PUNËS

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS

Në bazë të Nenit 29 pika 2.2 të Ligjit të RTK-së dhe nenit 36 paragrafi 5 të Statutit të RTK-së, Bordi i RTK-së më datë 10.09.2018, amandamentoi rregulloren për:

METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT TË NDËRLIKUESHMËRISË SË VENDEVE TË PUNËS

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është që të gjitha vendet e punës në nivelin e RTK-së, varësisht nga ndërlikueshmëria dhe rëndësia e punës, të klasifikohen sipas shkallës së peshës së tyre. Metodologjia mundëson përdorimin e kritereve të njëjta të përpilimit dhe të plotësimit të mëvonshëm të përmbajtjes së Katalogut të vendeve të punës. Katalogu i vendeve të punës me Metodologjinë është bazë për ndërtimin e strukturave organizative të RTK-së.

Neni 2

Udhëzimet për plotësimin e formularit "Përshkrimi i vendit të punës"

Formulari përmban të dhënat themelore, të cilat përcaktojnë kategorinë (ndërlikueshmërinë e punës) e vendit të caktuar të punës. Duke pasur parasysh që të gjitha të dhënat për vendet e punës duhet të rregullohen në mënyrë sistematike dhe që të dhënat në sistemet dhe nënsistemet e ndryshme të RTK-së të përputhen mes veti për nga metodologjia, është përgatitur formulari "Përshkrimi i vendit të punës".

Neni 3

Emërtimi i vendit të punës

Emërtimi i vendit të punës duhet që qartë dhe shkurt ta përcaktojë vendin e caktuar të punës.

Neni 4

Shifra e vendit të punës

Shifra e vendit të punës është e dhëna identifikuese për vendin konkret të punës, të cilën e përcakton Shërbimi i administratës dhe burimeve njerëzore.

Neni 5

Shkalla profesionale

Shkalla e përgatitjes së kërkuar profesionale përcaktohet përmes analizës së diturive të nevojshme teorike, të cilat i punësuari duhet t'i ketë, që të mundet me sukses t'i kryejë detyrat e vendit të punës.

Neni 6

Koeficienti

Koeficienti llogaritet me vlerën e ndërlikueshmërisë së vendit të punës, nga tabela: Ndarja e koeficientit sipas shkallës së pagesës në RTK.

Neni 7

Klasa e pagesës

Me metodologjinë e kërkesave të vendit të punës dhe të ardhurave bazë, përcaktohet shkalla e vendit të caktuar të punës mes vendit të punës me kërkesa më të mëdha dhe atij me kërkesa më të vogla. Gjithsej numri i klasës së pagesës është 46.

Neni 8

Pikët

Gjithsej pikë sipas kritereve nga 1.38 deri 9.25.

Neni 9

Përshkrimi

Në përmbajtjen e përshkrimit janë cekur të gjitha detyrat, përkatësisht janë cekur të gjithë përbërësit kryesorë në atë vëllim që të mund ta përcaktojmë lëmin e punës, si elementin më të rëndësishëm që e kërkon vendi i punës dhe rëndësinë e vendit të punës, përkatësisht qëllimit të hapjes së atij vendi të punës.

Neni 10

Kushtet e posaçme, njohuritë dhe aftësitë

Njohuritë e nevojshme funksionale janë ato njohuri, të cilat janë pranuar sistematikisht dhe të cilat i mundësojnë të punësuarit ta realizojë programin e punës dhe të arritjes së rezultateve të pritura të punës në vendin konkret të punës. Ato njohuri i punësuari i përvetëson me kryerjen e programeve të shkurta të specializimit dhe verifikimit të arsimimit. Në atë rubrikë ceken të gjitha njohuritë teorike dhe praktike, të cilat i punësuari duhet t'i njohë për kryerjen me sukses të detyrave në vendin konkret të punës. Të gjitha njohuritë funksionale, të cilat kërkohen për t'u pranuar në marrëdhënie pune, janë përcaktuar në Katalogun e njohurive funksionale.

Neni 11

Koha e nevojshme për arritjen e njohurive funksionale

Duke marrë parasysh vëllimin dhe ndërlikueshmërinë e njohurive të nevojshme funksionale, përcaktohet koha që nevojitet për arritjen e atyre njohurive. Nëse vendi i punës ka disa njohuri të tilla funksionale të kërkuara, në atë rast kohët e veçanta të nevojshme për arritjen e tyre mblidhen.

Neni 12

Të dhënat për udhëheqjen

Në rubrikë shënohen të dhënat vetëm për ato vende të punës ku realizohet funksioni i udhëheqjes. Përgjegjësia për punën e të tjerëve është më e madhe nëse në grupin punues punojnë më shumë punëtorë në korrelacion me shkallën më të lartë të kërkuar të shkallës së kërkuar përgatitjes profesionale.

Neni 13

Kriteret tek shpërndarja e vendeve udhëheqëse të punës

Vendi i punës duhet të rrjedhë nga struktura organizative e organogramit, nga përmbajtja e lëmit të punës duhet të dalin kompetencat për organizimin e punës, caktimin nëpër vendet e punës dhe udhëheqjes së punës në vendin konkret të punës. Në vendin e punës realizohet funksioni administrativ - bisedat vjetore me të punësuarit, gradimet, shpërblimet, zgjidhja e situatave konfliktuoze. Në atë nivel organizativ të udhëheqjes kryhet funksioni mbikëqyrës dhe plani i udhëheqjes.

Neni 14

Të dhënat mbi përgjegjësitë e ndikimit në punë

Te përcaktimi i shkallës së përgjegjësisë niset nga niveli organizativ i nivelit ku kryhen këto aktivitete, nga niveli i punës së pavarur dhe strukturës së udhëheqjes dhe mbikëqyrjes.

Neni 15

Të dhënat për praktikën e kërkuar

Pos shkallës së përgatitjes profesionale të kërkuar dhe të njohurive të kërkuara funksionale te çdo vend pune, përvoja është e rëndësishme për kryerjen me sukses të detyrave. Përcaktohet me interval të caktuar kohor, gjatë të cilit punëtori mund të arrijë rezultat normal të punës në kryerjen e detyrave në vendin konkret të punës. Praktika e detyrueshme është shumë e rëndësishme te rastet kur ndarja e punës mundëson shkallëzimin e ndërlikueshmërisë së vendeve të punës në profesionin e njëjtë. Si njëri nga elementet e nevojshme për punë është praktika e nevojshme, në bazë të të dhënave nga formulari i përshkrimit të vendit të punës në sistematizimin e vendeve të punës së RTK-së, të definuar në mënyrë më precize.

Neni 16

Të dhënat për mënyrën e punësimit

Në bazë të tipit të vendit të punës, plotësohet rubrika, e cila përcakton veprimin përkatës tek caktimi në vendin e punës.

Neni 17

Puna, tendosja

17.1 Pranohet kërkesa e tendosjes fizike, përkatësisht të aktivitetit fizik lidhur me ritmin e punës, pozitën e trupit dhe kohëzgjatjen e punës fizike, të cilit i nënshtrohet punëtori gjatë kryerjes së detyrave të punës.

17.2 Te përcaktimi i shkallës së tendosjes fizike përdoret shkalla 1. Më shumë se 50% të orarit të punës në vendin e punës punohet ulur, pa qëndrim të mundimshëm të trupit (më pak se 10%), kohë pas kohe detyrat kryhen edhe në këmbë (më pak se 20%). Ritmi i punës është normal, Përcaktimi tipik: p.sh. puna në zyrë, shkalla 2.

17.3 Kryerja e detyrave në vendin e punës kërkon punë mesatare fizike. Punëtori qëndron në këmbë apo ecë me vegla (pajisje) të rënda deri në 10 kg më gjatë se 50% të orarit të punës. Ndonjëherë ngrit edhe pesha më të rënda (më pak se 10% të orarit të punës.)

17.4Pozita e detyrueshme e trupit gjatë kryerjes së detyrës është më pak se 50%. Përcaktimi tipik: p.sh. puna e kameramanit televiziv, shkalla 3.

17.5Kryerja e detyrave përfshin punë më të rënda fizike. Punëtori kohën më të gjatë të orarit rri përkulur, përkatësisht punon në lartësi me vegla (pajisje) më të rënda se 10 kg (40% të orarit të punës apo më shumë). Ndonjëherë ngrit edhe pesha më të rënda. Përcaktimi tipik: p.sh. punët fizike te montimi i skenës.

17.6Tendosja psiko-senzorike, ky lloj lodhjeje varet nga intensiteti i kontaktit me njerëzit dhe kohëzgjatjen e tyre (tendosja psikike), përkatësisht nga rëndimi i shqisave njëkohësit me të qenit i përqendruar dhe kohëzgjatjen e tyre.

17.7Te përcaktimi i nivelit të kësaj tendosjeje përdoret shkalla: shkalla 1. Kryerja e detyrave e kushtëzuar me ngarkesë aktive deri në 50% të orarit të punës me njërin nga llojet e tendosjes psiko-senzorike, përkatësisht më pak se 30% të orarit të punës me të dy llojet e tendosjes psiko-senzorike, shkalla 2.

17.8Kryerja e detyrave të kushtëzuara me ngarkesë aktive deri në 50% të orarit të punës me të dy llojet e tendosjes, përkatësisht me më shumë se 50% të orarit të punës të një lloji të tendosjes. Përcaktimi tipik, p.sh.: puna e montazherit, shkalla 3.

17.9Kryerja e detyrave kushtëzohet me tendosje aktive të më shumë se 50% të orarit të punës me të dy llojet e tendosjes. Përcaktimi tipik: p.sh. puna në regji.

Neni 18

Të dhënat për kushtet e punës

18.1Të dhënat për procesin e punës në vendin konkret të punës. Prania e tri ndikimeve negative e vështirëson kryerjen normale të detyrave dhe për kryerësin e detyrave mund të jenë të pakëndshme, përkatësisht të dëmshme. Të gjitha ndikimet e rrethinës, të cilat është e mundur që përmes përmirësimeve (ndihmesave) teknike të mënjanohen apo të zbuten (pakësohen), nuk pranohen. Të dhënat për kushtet e punës janë të rëndësishme për mbrojtjen në punë.

18.2Ndikimet negative të rrethinës te kryerja e detyrës janë: ndriçimi artificial i vazhdueshëm, vezullimat dhe flakërimat e dritës, zëri më i lartë se 65 dB, rrezik nga ftohja, zhurma dhe dridhjet, dëmtueset kimik dhe pluhuri, ndyrësira dhe lagështia, ndriçimi i papërshtatshëm, si nevojë e procesit të punës.

Neni 19

Orari i punës

19.1Të dhënat për orarin e punës kanë ndikim shtesë në kushtet e punës në të cilat kryhen detyrat e vendit të punës në orarin më pak të përshtatshëm të punës.

19.2Te përcaktimi i shkallës përdoret shkallëzimi, shkalla 1. Orari i rëndomtë (normal) i punës. Në atë shkallë janë të mundshme ndërrimet në orarin e punës (deri 10% të fondit të përgjithshëm të orarit të punës).

19.3Shkalla 2, karakteristike për këtë orar të punës është puna në ndërrime dhe kujdestaritë. Planet e punës janë të fiksuar, përkatësisht më shumë se 50% të fondit të orarit të punës është caktuar në orarin normal të punës.

19.4Shkalla 3, ky orar pune më i rëndë krijohet, kur nga planet e punës dhe orari del që më shumë se 50% të orarit të punës është përcaktuar sipas orarit të veçantë, të dielave, përkatësisht gjatë festave.

Neni 20

Matrica për vërtetimin e korrektësisë së analizimit të vendeve të punës

20.1Përmbajtja e formularit "përshkrimi i vendit të punës" është optimal dhe i caktuar (përfundimtar) kur vërehen të gjitha karakteristikat dhe specifikat e punës në ambientin e punës me përshtatjen dhe harmonizimin e të gjitha kritereve përmes Matricës për vërtetimin e korrektësisë së analizimit të vendeve të punës.

20.2Elementet e vërteta të procesit të punës dhe kushtet e punës i krahasojmë me përkufizimet në matricë sipas shkallës së përgatitjes profesionale të kërkuar. Në matricë, për çdo shkallë kërkohet përgatitja profesionale, në përputhje me kriteret e caktuara, përkufizimet e përcaktuara. Në atë mënyrë mënjanohen të gjitha lajthitjet eventuale sipas kritereve të caktuara të kërkuara për vendet e punës, përkatësisht të nën-kritereve te vendet e njëjta, përkatësisht të ngjashme, të punës në nivel të RTK-së.

20.3Përcaktimi (analizimi) jashtë kufijve të lejuar në matricë profesionalisht është jo korrekt dhe i palejueshëm.

MATRICA PËR VËRTETIMIN E KORREKTËSISË TË ANALIZIMIT TË VENDEVE TË PUNËS

PËRGATITJA PROF. / KRITERET E KËRK. / TË VENDEVE TË / PUNËS	I	II	III	IV	V	VII
Koha e duhur për arritjen e njohurive funksionale	1	1	1 2	1 2 3	1 2 3	1 2 3 4
Të dhënat për udhëheqjen				1	1	1 2 3
Të dhënat për përgjegjësitë – ndikimit në punë	1	1	1	1 2	1 2	1 2 3
Të dhënat për praktikën e kërkuar(detyrueshme)	1	1 2	1 2	1 2 3	1 2 3 4	1 2 3 4
Tendosja fizike	1 2 3	1 2 3	1 2 3	1 2 3	1 2 3	1
Tendosja psiko-senzorike	1 2	1 2	1 2	1 2 3	1 2 3	1 2 3
Të dhënat për kushtet e punës	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2
Të dhënat për orarin e punës	1 2 3	1 2 3	1 2 3	1 2 3	1 2 3	1 2 3

Matrica për vërtetimin e korrektësisë së analizimit të vendeve të punës

Neni 21

Shkalla e përgatitjes së duhur profesionale

21.1Punët më të thjeshta – shkolla fillore e kryer (I).

21.2Punët me kërkesa më të vogla – shkolla fillore e kryer, me kurse të kryera për punët e profesionit të caktuar, në kohëzgjatje prej 2 deri 3 muajsh (II).

21.3Punët me kërkesa mesatare – shkolla e mesme e kryer profesionale (III).

21.4Punët me kërkesa të mëdha – shkolla e kryer e mesme (IV-V).

21.5Puna më e ndërlikuar – kualifikim superior (VII).

Neni 22

Koha e duhur për arritjen e njohurive funksionale

22.1Shkalla 1, deri në 3 muaj.

22.2Shkalla 2, deri në 1 vit.

22.3Shkalla 3, deri në 2 vite.

22.4Shkalla 4, mbi 2 vite.

Neni 23

Të dhënat për udhëheqjen

23.1Deri në 10 punëtorë me përgatitje shkollore të mesme ose më shumë se 10 punëtorë me përgatitje shkollore më të ulët se të mesme.

23.2Deri në 10 punëtorë me përgatite të lartë shkollore apo më shumë se 10 punëtorë me përgatitje shkollore të mesme.

23.3Deri në 10 punëtorë me shkollë të lartë apo më pak se 10 punëtorë me përgatitje të lartë shkollore.

Neni 24

Të dhënat mbi përgjegjësitë – ndikimit në punë

24.1Përgjegjësia kontrollohet në nivelin e njësisë më të ulët.

24.2Përgjegjësia kontrollohet në nivelin e njësisë themelore.

24.3Përgjegjësia kontrollohet në nivelin e ndërmarrjes.

Neni 25

Të dhënat për shkallën e tendosjes në vendin e punës

25.1.Tendosja fizike

25.1.1. Shkalla 1 - e rëndomtë.

25.1.2. Shkalla 2 - tendosje mesatare– tendosja statike përkatësisht dinamike deri në 50% të orarit të punës.

25.1.3. Shkalla 3 - tendosja e madhe– tendosja statike përkatësisht dinamike mbi 50% të orarit të punës.

25.2.Tendosja psiko-senzorike

25.2.1. Shkalla 1 - e rëndomtë.

25.2.2. Shkalla 2 - Tendosja mesatare – psikike përkatësisht tendosja senzorike deri në 50% të orarit të punës.

25.2.3. Shkalla 3 - tendosja e madhe – tendosja psikike përkatësisht senzorike mbi 50% të orarit të punës.

Neni 26

Të dhënat për kushtet e punës

26.1. Shkalla 1 - të përshtatshme.

26.2. Shkalla 2 - të papërshtatshme – deri në 30% të orarit të punës bile të 2 tendosjeve negative.

26.3. Shkalla 3 - të dobëta – deri në 50% të orarit të punës të bile 2 tendosjeve negative.

26.4. Shkalla 4 - shumë të dobëta – mbi 50% të orarit të punës të bile 2 tendosjeve negative.

Neni 27

Të dhënat për orarin e punës

27.1. Shkalla 1 - e rëndomtë (normale).

27.2. Shkalla 2 - mesatarisht e rëndomtë (puna në ndërrime).

27.3. Shkalla 3 - shumë e tendosur (sipas orarit të veçantë, të dielat, festat).

Neni 28

Metoda e krahasimit në çifte

28.1. Krahasimi në çifte bëhet mes dy vendeve të punës brenda shkallës së njëjtë të përgatitjes së kërkuar profesionale dhe mes kritereve të caktuara të analizës. Krahasimi i cilit do vend pune nga procesi i punës së RTK-së, me vendin përkatës të punës nga vendi tipik i punës, bazohet në krahasimin sipas kërkesave të përgatitjes profesionale dhe të elementeve të tjera të përcaktimit të kërkesave të punës.

28.1.1 elementet e ndërlikueshmërisë së punëve (të dhënat për udhëheqjen, të dhënat për përgjegjësitë në punë)
28.1.2 përvoja e nevojshme e punës (në vite)
28.1.3 elementet e tendosjes në punë (fizike dhe psiko-senzorike),
28.1.4 elementet e kushteve të punës (ambienti i punës dhe orari i punës).

28.2. Në bazë të metodave të krahasimit në çifte, krahasohen kërkesat e punës mes vendeve të punës nga tabela "Harmonizimi horizontal i vendeve të punës në RTK", e në anën tjetër mes analizave (të elementeve të lartpërmendura) të vendit të krahasuar të punës.

28.3. Shpërndarja e vendeve të tjera të punës në RTK në klasat e pagës të vendit individual të punës përcaktohet në varësi nga numri i përgjithshëm i pikëve brenda grupit të caktuar të punëve. Shpërndarja bëhet në bazë të krahasimit mes dy vendeve të punës dhe atë në përgjithësi ose në bazë të krahasimit sipas elementeve individuale të elementeve të analizimit të vendeve të punës.

28.4. Krahasimi në përgjithësi ka kuptim në ato raste kur marrëdhëniet relative mes vendeve individuale në praktikë tashmë të caktuara dhe me kusht që në kohën e caktuar te ato vende të punës nuk ka ardhur deri te ndërrimi i përmbajtjes dhe teknologjisë së kryerjes së detyrave, të cilat do të mund të ndikonin në ndërrimin e shkallë së kërkesës së punë të vendit konkret të punës.

Neni 29

Klasifikimi i klasave të pagesës brenda grupit të shkallës së kërkuar arsimore

29.1. Mes kërkesave individuale të shkallës arsimore, janë shtuar klasat e pagesës me qëllim që kalimet e kërkesa të punës mes kërkesave individuale të shkallës së kërkuar arsimore të vendeve të punës të bëhen më të lehta, elastike. Në sistemin e pagesave të RTK-së janë marrë 40 klasa pagesash (nga klasa 1 e pagesës deri te klasa 40 e pagesës) me koeficientin vlerësues të kërkesave të punës prej 1,00 (klasa 1 e pagesë) deri në 7,00 (klasa 40 e pagesës).

29.2. Në tabelat "Shpërndarja e koeficienteve sipas klasave të pagesës" dhe "Shpërndarja e klasave të pagesës në sistemin e pagesë të RTK-së" është përcaktuar numri i klasave të pagesës dhe koeficientet e tyre përkatëse në kufijtë e shkallës profesionale individuale arsimore.


RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS

KLASA E PAGËS	SHKALLAEKËRKUARARSIMORE					
	I	II	III	IV	V	VII
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						

21						
22						
23						
24						
25						
26						
27						
28						
29						
30						
31						
32						
33						
34						
35						
36						
37						
38						
39						
40						

Tabela : Shpërndarja e klasave të pagesës në sistemin e pagesave të RTK-së.

6.0 Grafiku i shpërndarjes së koeficienteve



Neni 30

Njohuritë funksionale

Njohuritë funksionale mundësojnë realizimin e programit të punës dhe të arritjes së rezultateve të pritura të punës. Këto njohuri plotësuese, nëse janë të përcaktuara me sistematizim, janë të obligueshme me rastin e plotësimit të shërbimit të administratës dhe burimeve njerëzore të vendeve të sistematizuara të punës. Njohuritë funksionale të cilat dalin nga kushtet e procesit të punës në vendin konkret të punës, janë përcaktuar në formularin "Përshkrimi i vendit të punës" dhe më tej në Tabelën e sistematizimit të vendeve të punës të RTK-së. I punësuari e dëshmon plotësimin e njohurive të kërkuara funksionale përmes dokumentit të institucionit arsimor të verifikuar (institucionet e jashtme arsimore përkatësisht në procesin e arsimit të brendshëm të organizuar të RTK-së, kur ajo të institucionalizohet dhe verifikohet).

Neni 31

Katalogu i njohurive funksionale

Shifrat e njohurive funksionale janë si në vijim:

01	Njohja aktive e një gjuhe të huaj
02	Provimi profesional
03	Provimi i jurisprudencës
12	Provimi pedagogjik – andragogjik
13	Provimi profesional për revizor
14	Provimi profesional për elektricist
20	Patentë shoferi për kategorinë B
21	Patentë shoferi për kategoritë B dhe C
22	Patentë shoferi për kategorinë D
23	Provimi për punë në kaldajat me shtypje
24	Provimi për mbrojtje nga zjarri
26	Provimi i mbrojtjes në punë
27	Testi për punë në lartësi
28	Kursi specialistik
29	Testi audio-vizual
30	Testi audio-vizual për xhiruesin
31	Kursi i punës në Kompjuter
32	Njohuri teknologjike të llogarimbajtjes
33	Njohja e një gjuhe programuese objekt-orientuese

Neni 32

Vendet tipike të punës në RTK

Kjo përzgjedhje e vendeve të zgjedhura të punës është përgatitur me qëllim të përgatitjes së bazës metodologjike në fazën e përcaktimit të të gjitha vendeve të punës në RTK në shkallët përkatëse të shkallës së kërkuar arsimore dhe të klasës së pagesë. Zgjedhja e vendeve tipike të punës dhe puna e kërkuar (klasa e pagesës), Ekipi projektues e ka përcaktuar dhe ajo është pjesë përbërëse e Tabelës horizontale të ndarjes së vendeve të punës. Çdo ndryshim i punës së kërkuar të vendit tipik të punës (në bazë të ndërrimit të organizimit, kushteve të punës, përkatësisht të ndërrimit të procedurave teknologjike) e përcakton Ekipi dhe e shton në Tabelën horizontale të ndarjes së vendeve të punës.

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS

Harmonizimi horizontal i vendeve të punës

Shkalla e kërkuar arsimore	Klasa e pagës	Koeficienti	Vendet tipike të punës	Vendet e tjera të punës
III.	8	1.38	pastrues	Pastrues
	9	1.44		
	10	1.51		
IV.	11	1.58		
	12	1.66		
	13	1.74	punëtor skenik	Punëtor skenik
	14	1.82		
	15	1.90	mjeshtër skene	Mjeshtër skene
	15	1.90	post shpërndarës	Postë shpërndarës
	15	1.90		Recepsionist
	15	1.90		Operator në mirëmbajtje
V.	16	1.99		Ndihmës xhirues ENG
	16	1.99		Ndriçues 2
	16	1.99		Organizator 2
	16	1.99	punëtor i mbrojtjes dhe shpëtimit	Punëtor i mbrojtjes dhe shpëtimit
	17	2.09		Autoskripta
	17	2.09		Organizator në studio
	17	2.09		Grimer
	17	2.09	mirëmbajtës-shtëpiak	Mirëmbajtës-shtëpiak
	18	2.19		Montues i pajisjeve teknike
	19	2.29		Folës
	19	2.29		Arkivist në administratë
	19	2.29	Vozitës	Vozitës
	20	2.40		Montazher 2
	20	2.40		Operator në titrim
	20	2.40		Teknik i zërit 2
	20	2.40		Video teknik
	20	2.40		Arkivist
	20	2.40	ndriçues 1	Ndriçues 1
	20	2.40		Organizator 1
	20	2.40		Operator në grafikë
	20	2.40		Depoist
	20	2.40		Operator në videoserver
	21	2.51		Planer koordinator - produksioni
	21	2.51		Operator në MCR 2
	22	2.63		Arkivisti kryesor
	22	2.63		Asistent i marketingut
	22	2.63		Zyrtar i prokurimit-furnizues
	22	2.63		Asistent i marketingut- monitorues
	22	2.63		Asistent administrativ
	22	2.63		Teknik në transmetues
	22	2.63		Teknik në energjetikë
	23	2.75		
	24	2.88		Operator në MCR 1
	24	2.88		Teknik në TI
	24	2.88	kameraman 2	Kameraman 2
	24	2.88		Xhirues 2
	24	2.88		Mbikëqyrës i arkivit dhe bartjes

	24	2.88	teknik në transmetim dhe lidhje	Teknik në transmetim dhe lidhje
	24	2.88		Teknik në mirëmbajtje të aparaturës
	24	2.88		Asistent i marketingut-montazher
	24	2.88		Shef i mbrojtjes dhe sigurisë
	24	2.88		Udhëheqës i autoparkut
	24	2.88		Teknik i zërit 1
	24	2.88		Teknik në Youtube
	24	2.88		Teknik në Facebook
	25	3.02		Inxhinier në TI 2
	25	3.02		Gazetar bashkëpunëtor
	25	3.02		Koordinator i skemës programore
	26	3.16		Gazetar përpunues
	26	3.16		Kameraman 1
	26	3.16		Koordinator në programet e huaja
	26	3.16		Bashkëpunëtor i muzikës
	26	3.16		Stilist
	26	3.16		Planer koordinator në program
	26	3.16		Mjeshtër i ndriçimit
	26	3.16		Mjeshtër toni
	26	3.16		Gazetar-moderator 2
	26	3.16		Koordinator i promocionit
	26	3.16		Asistent në menaxhment
	26	3.16		Koordinator i kontrollit të programit
	26	3.16		Kryeteknik në produksion
	26	3.16		Kryeteknik
	26	3.16		Interpretues i gjuhës së shenjave
	26	3.16		Përkthyes
	27	3.31		Gazetar i sportit
	27	3.31		Gazetar në EVN
	27	3.31		Inxhinier në energjetikë dhe ndriçim
	27	3.31		ueb-dizajner
	27	3.31		Udhëheqës i njësisë së fotog. dhe ndriçimit
	27	3.31		Dizajner grafik
	27	3.31		Gazetar 2
	27	3.31		Gazetar-redaktor në ueb-faqe
	27	3.31		Xhirues 1
	27	3.31		Montazher 1
	27	3.31		Videomikser/realizator
	27	3.31		Koordinator i skemës programore TV
	27	3.31		Producent në program
	27	3.31	skenograf	Skenograf
	27	3.31		Producent i emisionit
VII.	27	3.31		Realizator në MCR
	28	3.46		Inxhinier në mirëmbajtje 1
	28	3.46		Inxhinier në sistem
	28	3.46		Udhëheqës i Njësisë së zërit
	28	3.46		Gazetar komentator i sportit
	28	3.46	regjisor 2	Regjisor 2
	28	3.46		Mbikëqyrës në MCR
	28	3.46		Mbikëqyrës i skemës programore
	28	3.46		Zyrtar i të hyrave
	28	3.46		Gazetar-moderator 1
	28	3.46		Zyrtar për siguri në punë
	28	3.46		Gazetar në EVN
	28	3.46		Koordinator në programet e huaja
	28	3.46		Redaktor gjuhësor
	28	3.46		Audioinxhinier

28	3.46		Mbikëqyrës i Njësisë së përkthimit dhe redaktimit gjuhësor
28	3.46		Inxhinier në energjetikë dhe ndriçim
29	3.62		Redaktor planifikues
29	3.62	gazetar 1	Gazetar 1
29	3.62		Udhëheqës i Njësisë së xhiruesve
29	3.62		Udhëheqës i Njësisë së montazherëve
29	3.62		Udhëheqës i Njësisë së kamerës
29	3.62		Udhëheqës i Njësisë së skenografisë
29	3.62		Udhëheqës i dizajnit grafik
29	3.62		Asistent redaktor
29	3.62		Redaktor i muzikës
29	3.62		Koordinator i producentëve/organizatorëve
30	3.79	gazetar specialist	Gazetar specialist
30	3.79		Këshilltar artistik
30	3.79		Udhëheqës i logjistikës
30	3.79		Zyrtar i administratës dhe burimeve njerëzore
30	3.79		Zyrtar i kontabilitetit
30	3.79		Asistent administrativ në Bord
30	3.79		Zyrtar i operativës financiare
30	3.79		Zyrtar i marketingut
30	3.79	zyrtar i prokurimit	Zyrtar i prokurimit
30	3.79		Zyrtar ligjor
30	3.79		Zyrtar i Arkivit
31	3.97		Redaktor i redaksisë 2
31	3.97		Këshilltar për skemë programore
31	3.97		Gazetar-korrespondent
31	3.97		Zyrtar i pasurisë
31	3.97		Inxhinier në TI - Arkiva
31	3.97		Redaktor i redaksisë së muzikës
31	3.97		Reporter televiziv
32	4.16		Asistent në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm
32	4.16		Mjeshtër i kamerës
32	4.16		Inxhinier përgjegjës në energjetikë
32	4.16		Inxhinier përgjegjës për mirëmbajtje dhe zhvillim
32	4.16		Inxhinier përgjegjës Teknika mobile
32	4.16		Inxhinier përgjegjës Teknika e Studios
32	4.16		Inxhinier përgjegjës Teknologjia digjitale
32	4.16		Inxhinier përgjegjës Transmetim dhe Lidhje
32	4.16		Mjeshtër i montazhës
32	4.16		Redaktor i programit
33	4.36		Regjisor 1
33	4.36		Menaxher për projekte dhe zhvillim
33	4.36		Inxhinier në TI - Net Adm
33	4.36		Udhëheqës i Qendrës për Aftësim Profesional
33	4.36		Hulumtues i programit
33	4.36		Redaktor i edicionit (i lajmeve)
34	4.56		Zyrtar certifikues
34	4.56		Redaktor i redaksisë 1
34	4.56		Inxhinier në TI 1
34	4.56		Ueb-master
34	4.56		Udhëheqës i Njësisë së regjisë dhe realizimit

	34	4.56		Redaktor i edicionit qendror te lajmeve
	34	4.56		Udhëheqës i Njësisë së Arkivit
	35	4.70		Mbikëqyrës artistik i programeve të veçanta
	36	4.78		Zyrtar i lartë i marketingut
	36	4.78		Zyrtar i lartë i administratës dhe burimeve njerëzore
	36	4.78		Zyrtar i lartë ligjor
	36	4.78		Zyrtar i lartë i kontabilitetit
	36	4.78		Zyrtar i lartë i operativës financiare
	37	5.00		Inxhinier në TI 1 TV
	37	5.00		Inxhinier në TI – SYS
	37	5.00		Menaxher për arkiv
	37	5.00		Menaxher për zhvillimin e medias
	37	5.00		Udhëheqës i promocionit
	37	5.00		Producent ekzekutiv
	37	5.00		Udhëheqës i shërbimit programor
	37	5.00		Udhëheqës i MCR dhe skemës programore
	37	5.00		Udhëheqës i Njësisë së pasurisë
	37	5.00		Udhëheqës i Njësisë së hulumtimit
	38	5.40		Kryeredaktor në ueb-faqe
	38	5.40		Analist i tregut të marketingut
	38	5.40		Menaxher i Njësisë për të Drejtat Autoriale
	38	5.40		Analist për audiencë dhe hapësirë komerciale
	38	5.40		Menaxher i kontabilitetit
	38	5.40		Menaxher i administratës dhe burimeve njerëzore
	38	5.40		Menaxher operativ i marketingut
	38	5.40		Menaxher për legjislacion të medias
	38	5.40		Menaxher për digjitalizim
	38	5.40		Menaxher i kostos financiare
	38	5.40		Menaxher i operativës financiare
	38	5.40		Auditor i brendshëm
	38	5.40	redaktor përgjegjës i programit	Redaktor përgjegjës i programit
	38	5.40		Redaktor përgjegjës i programit për komunitete
	38	5.40		Zyrtar për komunikim (me publikun)
	39	6.00		Menaxher për teknologji dhe transmetim
	39	6.00		Menaxher për strategji
	39	6.00		Menaxher për marrëdhënie ndërkombëtare
	39	6.00	udhëheqës i produksionit TV	Udhëheqës i produksionit TV
	39	6.00		Udhëheqës i produksionit Ra
	39	6.00		Udhëheqës i NJAB
	39	6.00		Udhëheqës i teknikës TV
	40	7.00		Udhëheqës i Zyrës Ligjore
	40	7.00		Udhëheqës i programit satelitor
	40	7.00		Udhëheqës i administratës dhe burimeve njerëzore
	40	7.00		Udhëheqës i financave
	40	7.00		Udhëheqës i marketingut
	40	7.00		Udhëheqës i prokurimit
	41	7.20		Kryeredaktor në Radio
	41	7.20		Kryeredaktor Mediat Online
	42	7.50		Udhëheqës për Strategji dhe Zhvillim
	42	7.50		Udhëheqës për marrëdhënie ndërkombëtarë dhe komunikim
	43	8.20		Drejtor i RTK 2 TV
	43	8.20		Drejtor RTK-Radio

	43	8.20		Udhëheqës i shërbimeve të përbashkëta
	44	8.5		Udhëheqës i IT-së
	45	8.70		Drejtor i RTK TV 1, 3 dhe 4
	46	9.25		Zv. Drejtor i Përgjithshëm

Neni 33

Dispozita përfundimtare

1. Versionet e këtij akti në gjuhën Shqipe dhe Serbe janë të barasvlershme. Në rast mospajtimi, përparësi ka versioni në gjuhën shqipe.

2. Kontratat e nënshkruara paraprakisht që tejkalojnë koeficientet me këtë rregullore, nuk ju nënshtrohen ndryshimit të koeficienteve sipas kësaj rregullore për kategoritë e caktuara, deri ne skadimin e tyre.

3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja për metodologjinë e Përcaktimit të Ndërlikueshmërisë së Vendeve të Punës, e datës 29.11.2017.

Neni 34

HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas nënshkrimit të saj.

Kryetare e Bordit të RTK-së

Afërdita Maliqi

RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0131/24
Data 28.11.2024
PRISHTINË

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës:

Në mbështetje të Nenit 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-046 për RTK-në dhe Nenit 17, paragrafi 17.2, nënparagrafi 2 i Statutit të RTK-së dhe Raporti i Grupi punues për plotesim/ndryshimin e Rregullorës për metodologjinë e përcaktimit të ndërlikueshmërisë së vendeve të punës në RTK, Bordi i RTK-së:

Aprovon

Ndryshimin e Rrregullores Metodologjia e Përcaktimit të Ndërlikueshmërisë së Vendeve të Punës me numër protokolli 1363/18 të datës 26.10.2018

Neni 1

Neni 8, i Metodologjia riformulohet si në vijim:

Gjithsej pikë sipas kritereve nga 9 deri 25

Neni 2

Neni 29, paragrafi i parë i Metodologjisë bazike, riformulohet si në vijim:

Mes kërkesave individuale të shkallës arsimore, janë shtuar klasat e pagës me qëllim që kalimet e kërkesave të punës mes kërkesave individuale të shkallës së kërkuar arsimore të vendeve të punës të bëhen më të lehta, elastike. Në sistemin e pagesave të RTK-së janë marrë 46 klasa pagesash (nga klasa 1 e pagesës deri te klasa 46 e pagesës) me koeficientin vlerësues të kërkesave të punës prej 1,82 (klasa 14 e pagesës) deri në 9,25 (klasa 46 e pagesës).

Neni 29, tabelat në paragrafi i dytë i Metodologjia bazike: "Shpërndarja e koeficienteve sipas klasave të pagesës" dhe "Shpërndarja e klasave të pagesës në sistemin e pagesë të RTK-së", riformulohet si në vijim:


Ky plotësim/ndryshim i rregullores bazike nr. 1363/18, date 26.10.2018 është për afruar plotësisht me Ligjin Nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pages minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/218 i dt. 28.08.2024, për përcaktimin e pages minimale në Republikën e Kosovës

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS

KLASA E PAGËS	SHKALLA E KËRKUAR ARSIMORE					
	I	II	III	IV	V	VII
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						
26						
27						
28						
29						
30						
31						
32						
33						
34						
35						
36						
37						
38						
39						
40						
41						
42						
43						
44						
45						
46						

Tabela : Shpërndarja e klasave të pagesës në sistemin e pagesave të RTK-së.

Ky plotësim/ndryshim i rregullores bazike nr. 1363/18, date 26.10.2018 është për afruar plotësisht me Ligjin Nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pages minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/218 i dt. 28.08.2024, për përcaktimin e pages minimale në Republikën e Kosovës



Grafiku i shpërndarjes së koeficienteve

Neni 3

Klasa e pagës, koeficientet, pikët dhe shkalla e kërkuar arsimore për vendet të punës "Pastrues" dhe "Punëtor skenik" ndryshohet ne Klasa e pages: 14 dhe Koeficienti: 1.82, pikët: 9 dhe shkalla e kërkuar arsimore: III.

Neni 4

Kjo rregullorehyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i RTK-së.

Kryetare e Bordit të RTK-së

Albulena Mehmeti

Ky plotësim/ndryshim i rregullores bazike nr. 1363/18, date 26.10.2018 është për afruar plotësisht me Ligjin Nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pages minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/218 i dt. 28.08.2024, për përcaktimin e pages minimale në Republikën e Kosovës